

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

I. HYRJE.

Kultivimi i ullirit dhe arti i nxjerrjes së vajit të ullirit, është një nga veprimtaritë bujqësore shumë të herëshme dhe nga më të rëndësishmet në vendin tonë. Sot trashëgohet një traditë e vyer olivikole dhe një pasuri e madhe llojesh, ekotipesh e popullatash autoktone nga të cilat janë tipizuar dhe rajonizuar kultivarë vendi me shumë vlera të cilët paraqesin interes edhe në ditët e sotme. Por duhet thënë se ullishtaria në vendin tonë ka patur zhvillime pozitive ashtu siç ka patur dhe dështime, në përputhje me politikat ekonomike që janë ndjekur në periudha të ndryshme kohore.

Ndryshimet social- ekonomike që ndodhën në vitet 1990, sollën ndryshim edhe në gjendjen e ullishtarisë së trashëguar, mbjelljen e ullinjve si dhe të ndërtimit të linjave teknologjike të përpunimit të ullirit dhe prodhimit të vajit.

Sipas vlerësimeve të studiuesve të ndryshëm sipërfaqet e mbjella me ullinj apo siç thirren ullishtat është rreth 40 mijë hektarë me rreth 6 milion bimë, prej të cilave rreth 10 % janë pemë shekullore. Aktualisht ullishta administrohet nga rreth 60 mijë ferma familjare. Në ullishtarinë ekzistuese dominon kultivari Kalinjot rreth 40 %, i kultivuar në bregdetin Jonian Vlorë, Sarandë dhe Mallakastër dhe Kokërrmadh Berati me 20 % të numrit të përgjithshëm të rrënjëve. Pjesa tjetër janë Kokërrmadh i Elbasanit 8%, Mixan 5%, Ulliri i Bardhë i Tiranës dhe Nisioti me 3%. Nga kultivarët e huaj Frantoio zë 8%.

Prodhimi mesatar i vajit të ullirit në çdo vit të njëpasnjëshëm është në nivlet 6-8 mijë ton. Paralelisht me vajin janë përpunuar për konsum në tryezë rreth 6 mijë ton ullinj. Ullishtet e reja me karakter ½ intensiv të krijuara këto 10-15 vitet e fundit kapin shifrën e 5-6 mijë hektarë.

Industria e prodhimit të vajit të ullirit është transformuar totalisht. Në teritorin e vendit tonë janë instaluar 180 fabrika apo linja teknologjike të tipeve dhe kapaciteteve të ndryshme, duke formuar një kapacitet mbi 85000 kg/orë. Por, investimet në fushën e marketingut të produktit janë ende të vogla dhe vlerësohen se sapo kanë filluar.

Përfitimi maksimal prej një ullishteje merret kur vlerësohen dhe punohet për zbatimin e tre faktorëve të rëndësishëm, që janë **Varieteti – Dendësi e mbjelljes – Sistemi i mirëmbajtjes.**

Vareiteti. Në zgjedhjen apo vlerësimin e një varieteti, duhet të përcaktohet së pari qëllimi për të cilin do destinohen frutat pas vjeljes: për tryezë (jeshile apo të zeza) ose për prodhim vaji. Vendi ynë mund të rajonizohet në dy zona klimaterike : zona jonike dhe zona adriatike. Për çdo njerën prej këtyre zonave duhet të aplikohet një listë varitetesh të cilët mund të jenë më rentabël se të tjerët.

Dendësia e mbjelljes. Nga studimet të ndryshme rezulton se rreth 80% e ullishteve kanë më pak se 100 bimë për hektarë dhe, vëllimi i kurorës që arrijnë bimët për çdo hektarë është gati i pandryshueshëm dhe i pavarur nga dendësia e mbjelljes. Prodhimi është i lidhur ngushtë me sipërfaqen e jashtme të kurorës (sipërfaqe frutifikimi). Me shtimin e dendësisë së mbjelljes për një vëllim të caktuar vëllimi për çdo bimë zvogëlohet, por rritet shumë sipërfaqja e frutifikimit për njësinë e sipërfaqes. Në këtë kontekst një shtim i arsyeshëm i numrit të bimëve për hektar,

bën shfrytëzimin në maksimum të terrenit në një periudhë të shkurtër kohe gjë që arrihet vonë në mbjelljet me pak bimë.

Në ullishtet me më shumë se 400 bimë për hektarë është një konkurrencë serioze për dritë, ujë dhe lëndë minerale dhe të gjitha këto shoqërohen me ulje të prodhimit.

Sistemi i mirëmbajtjes. Kultivimi i ullirit duhet të bëhet mbi një trung dhe këtë formim duhet t'a realizojë fidanishtja përpara se ulliri të mbillet në vendin e përhershëm. Në vitet e para duhet të kemi një formë të lirë, globoze ose monokon, pa krasitje të rënda, pasi futja në prodhim dhe të ardhurat varen nga ky fakt. Në kohën kur ulliri ka arritur kohën për krasitje prodhuese duhet të ripërtërihen degëzat prodhuese në mënyrë periodike, si dhe reduktimi i degëve të treta me qëllim që të ruhet një volum konstant kurore dhe të pengohet konkurenca për ujë dhe dritë të cilat shpien në dëmtime të konstantes së prodhimit, prishjeve të cilësisë së frutave dhe ulje të rendimentit.

Zhvillimi i Ullishtarisë dhe Industrisë së përpunimit të vajit i dedikohet vlerave të larta ushqyese të ullirit dhe vajit të prodhuar prej tij, po ashtu edhe interesit ekonomik dhe tregtar në tregun vendas dhe atë të huaj.

Vaji i ullirit, është një nga vajrat më të preferuar nga konsumatori mbarë botëror, për shkak të cilësive dhe vlerave të larta ushqyese të tij dhe dobive të mëdha në shëndet. Kjo i dedikohet përbërjes së tij kimike dhe cilësisë organoleptike. Përmbajtja e lartë e acideve yndyrore të pangopura me një lidhje dyfishe dhe prania e përbërësve të tjerë të tillë si fenole, tokoferole, klorofil dhe feofitin, sterole, komponimet aromatike etj, luajnë një rol të rëndësishëm në shëndet. Vaji i ullirit përbëhet kryesisht nga trigliceride në 95 – 98 % dhe përmban sasi të vogla të një sërë komponimesh si acide yndyrore të lirë (AYL), glicerinë, fosfatide, pigmente, komponime aromatike, polifenole dhe sterole. Këta përbërës që ndodhen në sasi shumë të vogël i japin vajit të ullirit shije dhe aromë unike dhe kontribuojnë shumë në vlerat ushqyese të tij. Në vajin e rafinuar këto komponime largohen.

Vaji i ullirit është i vetmi vaj, për të cilin janë përcaktuar rregullore strikte nga Këshilli Ndërkombëtar i Vajit të Ullirit (COOI) dhe Bashkimi Europian (BE) në lidhje me kriteret e cilësisë, pastërtisë dhe metodat e analizimit të tyre. Këto rregullore dhe standarte janë përafëruar në legjislacionin e vendit tonë, përkatësisht me Ligjin Nr. 87/2013 *“Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit”*, V.K.M-së Nr.555, datë 27.06.2013, për miratimin e rregullores *“Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”* etj.

Subjekti KRISTINA IDRIZI është regjistruar pranë QKB me numër NIPT-ti M32923201U.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: ELBASAN, Shirgjan, Mjekës.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është: “Punishe vaji”.

Administratori i këtij subjekti është Znj. Kristina Idrizi.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet ti nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me **ID 7.7Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë lidhura me to.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedisin epunës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtuar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës si:

- Pa krijuar rreziqe për ujin, ajrin, tokën, florën dhe faunën.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa dëmtuar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subjekt.
- Njohja e gjëndjes reale e zhvillimit të kësaj veprimtarie nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.

- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.

- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subject te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”

III. INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ.

Linja teknologjike e prodhimit të vajit të ullirit, është e instaluar në një objekt që gjendet në fshatin Mjekës, Shirgjan të Bashkisë Elbasan. Ky fshat është rreth 7 km (në rrugë automobilistike) në jug të Qytetit të Elbasanit.

Në këtë zonë/truall gjenden edhe disa objekte të tjera në të cilat zhvillohen veprimtari të ndryshme prodhuese si një linjë e prodhimit të miellit, përpunimit të drurit, servis automjetesh, etj. Këto godina kanë shërbyer si objektet të qëndrimit dhe të kryerjes së shërbimeve mekanike, të makinerive bujqësore të ish kooperativës Shirgjan. Është një zonë/truall, i tjetërsua në shërbime industriale para më shumë se 50 vitesh, brenda një rajoni kryesisht bujqësor.

Objekti është i lidhur me rrjetet inxhinjrike të zonës të cilat ashtu si dhe vetë godina janë, rikonstruktuar dhe përshtatur me veprimtarinë që zhvillohet tani.

Furnizimi me energji elektrike të nevojshme merret nga rrjeti i këtij rajoni, mbështetur në kontratën përkatëse të bërë me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shpërndarjes. Brenda objektit është ndërtuar rrjeti i shpërndarjes së kësaj energjie në pajisjet punuese dhe në sistemet e ndriçimit të ambienteve të punës.

Furnizimi me ujë të pijshëm, bëhet nga rrjeti përkatës i zonës, në bazë të kontratës me subjektin që administron këtë rrjet. Uji shpërndahet në pikat e konsumit, nga rrjeti i brendëshëm i ndërtuar në objekt.

Objekti është i lidhur me rrjetin e kanalizimeve të shkarkimit të ujërave të bardha dhe të atyre të zeza të kësaj zone. Këto ujëra shkarkojnë pa asnjë lloj përpunimi paraprak në përroin e Llixhës i cili rrjedh disa metra larg, kufirit jugor të zonës.

Kjo zonë është e lidhur me rrugën automobilistike Elbasan – Tergan/Llixhë – Gramsh. Në brendësi të saj ka sheshe e rrugë të cilat sigurojnë një qarkullim normal të mjeteve të tonazheve të ndryshme brenda saj dhe në hyrje/daljet me rrugën kombëtare.

Investitorët kanë vlerësuar rrezikun e rënies së zjarreve, dhe kanë instaluar në pika të ndryshme të ambienteve të punës, fikse zjarri të volumeve 6 dhe 9 litra, me shkumë dhe pluhur. Ne rekomandojmë vlerësimin teknik të tyre në përshtatje me kohën në shërbim. Rekomandojmë gjithashtu vendosjen e një fiksjeje me shkumë me vëllim 15 litra apo më shumë, në magazinën e depozitimit të përkohshëm të bërsive të ullirit. Është mirë që pranë kësaj magazine të instalohet edhe një hidrant uji.

Linja teknologjike e instaluar dhe funksionale në këtë subjekt, bën të mundur realizimin e proceseve të suksesshme të prodhimeve të caktuara me cilësi të vlersueshme dhe konkurente në tregun e këtyre artikujve. Makineritë dhe pajisjet e instaluara janë, bashkëkohore kryesisht të importuara nga vendet e B.E.-së. Këto makineri dhe pajisje bashkëkohore vlerësohen miqësore me mjediset e vendeve të punës dhe më gjërë.

Objekti ku zhvillohet kjo veprimtari është organizuar në disa ambiente pune, të lidhur dhe në funksion të njëri - tjetrit. Ambientet e punës janë :

- Magazina e lëndës së parë;
- Linja e teknologjike e prodhimit të vajit;
- Magazina e depozitimit të prodhimit, në të cilën gjenden edhe pajisjet për mbushjen e vajit në enët prej plastike apo qelqi;
- Magazina e bërsive dhe kaldaja për ngrohjen e ujit;
- Ambientet hidro-sanitare;
- Ambientet e punës së personelit të shoqatës.

Cilësia e vajit të ullirit varet 60-70% nga cilësia e ullirit nga i cili ai prodhohet. Në cilësinë e ullirit ndikojnë faktorë të ndryshëm të cilët i përshkruajmë në vijim:

- a. Krasitja dhe standartizimi i kurorave;
- b. Mbajtja e një madhësie kurore të përshtatshme sipas kushteve, me ose pa ujitje në 7000 m³/ha nga 10-12 m³/ha;
- c. Menaxhimi i tokës me kritere për mbrojtjen nga erozioni dhe ruajtjen e pjellorisë duke përdorur teknika të mbulesës bimore, të punimeve të cekëta, të reduktuara ose teknika mospunimi;
- d. Rregullimi i të ushqyerit duke përdorur masivisht plehërimin gjethor dhe plehërimet e tjera me doza 5-6 kv/ha;

- e. Mbrojtja nga sëmundje e dëmtues, në veçanti nga miza e ullirit dhe syri i palloit nëpërmjet trajtimit me insekticide. Ullinjtë e prekur nga sëmundje apo dëmtues prodhojnë vaj me cilësi të dobët, i cili duhet ti nënshtrohet procesit të rafinimit që të jetë i konsumueshëm;
- f. Vjelja në kohë dhe dorëzimi në përpunim brenda ditës. Tashmë është përcaktuar faza e larosjes së frutit si periudha më optimale për vjelje, sepse në këtë fazë arrihet:
 - Maksimumi i përmbajtjes në vaj.
 - Niveli më i ulët i aciditetit të lirë në vajin e ekstraktuar.
 - Maksimumi i përmbajtjes së polifenoleve dhe tokoferoleve (antioksidues).
 - Prania e lartë e substancave që japin aromën. Koha optimale e vjeljes është sapo ka filluar larosja e ullirit.
- g. Përdorimi i mekanizmave të vogla për punime, trajtime antiparazitare dhe vjelje për uljen e kostos duke përdorur mjete në grup.
- h. Optimizimi i mjedisit. Uji është faktori kryesor kufizues i prodhimit të ullirit, çdo rritje e sasisë së ujit të disponueshëm për kultivim përkthehet në rritje të dukshme të prodhimit. Për këtë arsye është e rëndësishme përdorimi i sistemeve të kultivimit që rritin disponibilitetin e ujit për ullirin dhe sasinë e rrezatimit diellor të kapur nga kurora.
- j. Mënyra e vjeljes dhe ruajtja e ullinjve: Teknikat tradicionale manuale të vjeljes shmangin dëmtimin e frutit në krahasim me teknikat mekanike. Ruajtja e ullinjve në sasi jo shumë të mëdha, në arka të hapura shmang mundësinë e mbinxehjes së ullinjve që shkakton oksidimin dhe fermentimin. Ruajtja dhe transportimi i ullinjve në thasë të mbyllur dëmton shumë cilësinë e tyre.
- i. Prodhimi i vajit të ullirit

Prodhimi i vajit të ullirit në vendin tonë, llogaritet në rreth 7000 ton/vit, rreth 3.5 litra/banorë. Sot rezultojnë rreth 180 përpunues të ullirit, të shpërndarë kryesisht në Vlorë, Fier, Berat, Elbasan, Tiranë, Durrës, Krugë dhe Lezhë.

Vaji i ullirit është depo natyrale e shumë ushqyesve të shëndetshëm si vitamina A, E, D dhe K. Ushqyes të tjerë që gjenden në vajin e ullirit janë:


- Klorofila e pasur me magnez e cila ndihmon në formimin e qelizave të kuqe të gjakut, të shëndetshme.
- Skualene, nga të cilat derivojnë fitosterolet, që ndihmojnë në uljen e aciditetit.
- Fitosterolet (në formën e beta-sitosterolit) ndikojnë në parandalimin e absorbimit të kolesterolit.
- Ushqyesit kafeik dhe gallik stimulojnë rrjedhjen e lëngut biliar që ndihmon ushqimet alkaline të dalin nga stomaku, duke ulur stresin në pankreas.
- Komponentet fenolike mbrojnë nga fermentimi i yndyrave dhe kolesterolit dhe ndihmojnë prodhimin më të lartë të enzimave tretëse, të yndyrave në pankreas.

Studimet e shumta shkencore tregojnë se vaji i ullirit ka efekte pozitive në çdo aspekt të funksionimit të trupit, zhvillimit dhe mirëmbajtjes së tij, përfshirë zhvillimin e trurit, strukturës së kockave, tretjes, procesin e plakjes, gjendjen e lëkurës dhe flokëve dhe metabolizmin. Këto efekte pozitive në shëndet ndryshojnë sipas gradëve të vajit të ullirit, dhe në vajin e ullirit të rafinuar, i cili i nënshtrohet temperaturave të larta gjatë përpunimit, shkatërrohen ose ndryshojnë antioksidantët, si dhe largohen vitaminat. Për të patur një shëndet të mirë duhet të konsumohet vetëm vaj ulliri ekstra i virgjër.

ii. Proçeset e ekstraktimit të vajit të ullirit

Linjat teknologjike të instaluara në vendin tonë zakonisht përdorin dy proçese bazë për ekstraktimin e vajit të ullirit, proçesi i centrifugimit 2-fazor dhe atë 3-fazor. Këto proçese ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga sasia dhe përbërja e fraksioneve të ndryshme të nënprodukteve. Por, akoma përdoret dhe i ashtuquajti “proçesi tradicional”, i ekstraktimit të vajit të ullirit nëpërmjet presimit.

SKEMA TEKNOLOGJIKE E LINJËS SË PRODHIMIT TË VAJIT.



Sistemet e ekstraktimit të vajit të ullirit të paraqitura, nuk kanë ndryshime esenciale mes tyre, me përjashtim të procesit të presimit nga ai i centrifugimit.

Në vijim po përshkruajnë operacionet përbërëse të procesit teknologjik që zhvillohet në subjektin tonë.

Duhet të sqarohet se kemi të bëjmë me një subjekt i cili funksionon kryesisht me përpunimin e ullinjve që sjellin për përpunim fermerët e zonës. Pas përpunimit të sasisë së ullirit fermeri merr vajin e prodhuar, si dhe bërsitë të cilat ato i përdorin si pleh organik etj. Duhet të tregojmë se në një sipërfaqe prej 1 hektarë, mund të shpërndahen 50 – 80 m³ bërsi. Shpërndarja e tyre duhet të bëhet jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i tyre. Një pjesë e këtyre bërsive rreth 25 %, mbahet për t'u përdorur si lëndë djegëse në kaldajën e instaluar.

➤ **Proçesi i peshimit dhe larjes së ullinjve.**

Ullinjtë vijnë zakonisht në këtë objekt të futur në arka plastike por, edhe në thasë plastike të cilët, depozitohen në magazinën e tyre. Pas arritjes në subjektin e përpunimit, ullinjtë i nënshtrohen procesit të peshimit dhe larjes. Në shumicën e rasteve ullinjtë janë të përzier me gjethe dhe substanca të tjera të huaja si gjethe, bishta e degëza, pluhur dhe materiale të tjera të ngurta. Prandaj ato i nënshtrohen një sërë procesesh të cilët kryejnë largimin e të gjitha lëndëve të huaja. Këto veprime kryhen nga makineri të cilat punojnë të lidhura dhe ndërvarura nga njëra tjetra në mënyrë të automatizuar. Gjethet, bishtat etj largohen me ventilim në rryma ajri. Punëtori merr me rradhë çdo arkë dhe e hedh në mbajtësen metalike të linjës së prodhimit. Me anë të shtratit të pjerrët metalik, kokrrat e ullirit kalojnë në pajisjen larëse të tyre (lavatriçe) ku nën efektin e rrymës së ujit të ngrohtë dhe me një presion të caktuar ato i nënshtrohen procesit të larjes, gjatë të cilit largohen papastëritë së bashku me gjethet që ato mbartin. Lavatriçja ka një depozitë për mbajtjen e ujit si dhe një pompë e cila dërgon sasinë dhe presionin e duhur të ujit të nevojshëm për larje. Kjo sasi uji është gjithnjë në qarkullim duke u shtuar herë pas here, në vartësi të kërkesave të procesit.

➤ **Proçesi bluarjes.**

Ullinjtë e larë copëtohen e bluhën në pajisjen bluarëse pa ushtruar forcë të madhe mekanike dhe, pa shkaktuar emulsione dhe kontaminim nga metali. Gjatë zhvillimit të këtij procesi qelizat e tulit çahen në mënyrë që të ekstrahohet vaji dhe më tej të formohen pika më të mëdha të cilat ndahen nga fazat e tjera.

➤ **Proçesi i homogjenizimit.**

Pas bluarjes së ullinjve, pasta e përfunduar duhet të përzihet në mënyrë të vazhdueshme në pajisjen e përzierjes dhe të homogjenizimit. Pajisja homogjenizuese është e pajisur dhe me një sistem qarkullitë uji të nxehtë. Kjo pajisje është e ndërtuar prej çeliku inoksitabël për të shmangur kontaminimin e mundshëm nga metali. Niveli i temperaturës në të cilat zhvillohet normalisht ky proces janë rreth 30–35⁰C. Qëllimi i zhvillimit të këtij procesi është rritja e madhësisë së pikave të vajit, për të lehtësuar më tej ndarjen dhe për të ndaluar emulsionin vaj/ujë. Proçesi i homogjenizimit zgjat zakonisht zgjat disa minuta deri maksimalisht në një orë. Rritja

e kohës së homogjenizimit, ndikon negativisht në cilësinë e vajit, pasi sjell uljen e përmbajtjes së komponimeve fenolike.

➤ Proçesi i presimit/centrifugimit.

Sasia e madhe e mbetjeve të ujit që dalin gjatë zhvillimit të proçesit tre-fazor të përpunimit të vajit të ullirit është një problem mjedisor serioz për industrinë e prodhimit të vajit të ullirit. Kjo është një nga arsyet kryesore që disa prej prodhuesve të pajisjeve të linjave të vajit të ullirit prodhuan një model të ri të dekanorëve. Këto pajisje ndajnë vajin nga pasta e ullinjve pa shtuar ujë të ngrohë. Kjo do të thotë që nuk prodhojnë mbetje të mëdha ujore nga proçesi me përjashtim të ujit vegjetal nga ullinjët.

Ekstraktimi i vajit me anë të sistemit dy-fazor të centrifugimit dhe përftimi veças i vajit dhe bërsisë nga uji i vegetacionit kryhet nga zhvillimi i proçesit të centrifugimit të pastës dhe të fazës së lëngët.

• Centrifugimi i pastës.

Gjatë zhvillimit të këtij proçesi fazat vajore ndahen nga ullinjët (bërsi+ujë vegjetal) nga forca centrifugale, duke shfrytëzuar diferencën midis peshës specifike të vajit dhe fazës (bërsi+ujë vegjetal) në centrifuga horizontale apo dekantera. Në këtë rast nuk është e nevojshme shtimi i ujit të ngrohtë, për të pasur një ndarje më të mirë të vajit. Meqënëse faza vajore që del nga dekanteri mund të përmbajë grimca të ngurta, ajo kalohet në një sitë vibrimi për ndarjen e tyre.

• Centrifugimi i lëngut

Faza vajore i nënshtrohet centrifugimit në një centrifugë me pjata. Nëpërmjet shtimit të një sasive të caktuar uji, vajrat pastohen dhe u hiqet lagështia. Ky ujë është e vetmja mbetje e lëngët që del nga procesi i ekstraktimit.

Proçesi i ekstraktimit dy – fazor nuk prodhon mbetje të mëdha uji, vetëm një sasi të vogël të ujit larës të vajit në centrifugë. Cilësia e vajit të prodhuar në këtë proces është më e mirë se ajo e vajit të ekstraktuar nëpërmjet procesit tre – fazor, sepse përmban një koncentrim më të madh të polifenoleve dhe o-difenoleve. Kjo do të thotë se ky vaj është më i qëndrueshëm gjatë ruajtjes.

➤ Proçesi i ruajtjes dhe ambalazhimit të vajit të ullirit.

Tanket e ruajtjes së vajit janë prej materiali të papërshkrueshëm nga uji, inert ndaj vajit dhe të mos kontaminonjë ose oksidojnë vajin (metal). Tanket ruajnë vajin nga drita dhe ajri prania e të cilëve mund të sjellë ndryshime në cilësinë e tij dhe në temperaturë konstante (15-18⁰C), për të shmangur ndryshimet në vaj. Temperaturat e ulëta provokojnë ngrirjen e vajit, ndërsa temperaturat e larta sjellin oksidimin e tij.

Tek ne përdoren depozita prej çeliku të pandryshkur të kapaciteteve të ndryshme që variojnë në disa ton. Ato janë vendosur në një ambient/magazinë të mbuluara.

➤ Sistemi i qarkullimit dhe i ngrohjes së ujit.

Është instaluar një kaldajë me vëllim 3 m³ shërben për ngrohjen e ujit që përdoret në proçesin e larjes së kokrrave të ullirit, para futjes së tyre në proçesin e përpunimit. Një pjesë e këtij uji të ngrohtë përdoret për larjen e pajisjeve të ndryshme, larjen e enëve të ambalazhimit të vajit të

prodhuar, larjen e arkave plastike ku ishin vendosur ullinjtë si dhe të arkave plastike që përdoren për marrjen e bërsive nga centrifuga. Ky uji i ngrohtë punon në një sistem qarkullimi gjysëm të mbyllur, që nënkupton se ai ka mundësi të shtohet sa herë që shkarkojmë uji prej tij, duke ruajtur gjithnjë një sasi prej 3 m³. Ujërat teknologjikë që dalin gjatë larjes së ullinjve, të pajsive apo enëve mbajtëse të lëndëve të ndryshme, nëpërmjet rrjetit të tubacioneve shkarkojnë në një vaskë dekantuese dhe prej saj në rrjetin e kanalizimeve të zonës dhe në përroin e zonës aty pranë.

IV. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi.

4.1. Lëndët e para.

Prodhimet e këtij subjekti bëhen duke përdorur lëndë të parë ullirin. **Ulliri** (*Olea europaea*) është bimë subtropike nga familja "Oleaceae". Ulliri ka qenë pjesë e civilizimit mesdhetar që mijëra vjet më parë. Ulliri dhe vaji i ullirit janë përdorur për ushqim, gatim, mjeksi, sapun dhe ndriçim. Sot shumica e ullinjve të botës kultivohen në rajonin e Mesdheut.

Trungu i tij ka një formë jo të rregullt me gunga dhe me degëzime, gjethe ovale me ngjyrë të gjelbërt të errët në anën e sipërme ndërsa në anën e poshtme të bardhë në të argjendtë. Në periudhën e lulëzimit zhvillon lule të vogla të bardha në tufa, ndërsa fryti varësisht nga lloji është në formë vezake i zgjatur pak me ngjyrë jeshile të errët deri në të zezë. Fryti është i pasur me vaj i cili përdoret si ushqim dhe ka veti shëruese.

4.2. Energjitë që përdoren.

Objekti ku ndodhet fabrika e vajit është i lidhur me rrjetin inxhinjrik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjrik janë, ai i :

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm;
- ✓ Shkarkimi i ujrave "të ndotur";
- ✓ Sistem i mbrojtjes nga zjarri;

a. Furnizimi me energji elektrike.

Lidhja me rrjetin elektrik të zonës bëhet në mbështetje të kontratës me operatorin e shpërndarjes së kësaj energjije. Për të plotësuar nevojat për sasinë e energjisë dhe parametrat e qëndrueshëm teknik të saj, investitori në hyrje të objektit të tij ka instaluar një gabinë elektrike. Kështu ai siguron një furnizim të qëndrueshëm për punishten e vajit. Në punishten e vajit kemi një fuqi të instaluar prej rreth 35 kWh. Shpërndarja e rrymës elektrike në pajisjet e instaluara në këtë punishte vaji si dhe për sistemin e ndriçimit të ambienteve të punës dhe ato jashtë tyre, bëhet me anë të rrjetit shpërndarës të kompletuar me të gjitha pajisjet e nevojshme.

b. Furnizimi me ujë.

Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga rrjeti i furnizimit me ujë të fshatit, në bazë të kontratës përkatëse me subjektin që administron ujësjellësin e kësaj njësie administrative. Uji përdoret për plotësimin e nevojave humane të punonjësve dhe njëkohësisht si pjesëmarrës në disa procese pune të punishtes së vajit. Për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë, veçanërisht gjatë kohës që është në punë linja e përpunimit të ullirit, është instaluar një depozitë uji me vëllim 5 m^3 . Si pjesë e kësaj depozite është edhe pompa e ujit si dhe rrjeti i shpërndarjes së tij në të gjitha pikat konsumatore.

Gjatë periudhës së punës së punishtes së vajit, konsumi i ujit të pijshëm është rreth $15 \text{ m}^3/\text{muaj}$.

c. Shkarkimi i ujërave “të ndotur”.

Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë punës së linjës teknologjike, pastrimit të ambienteve të punës etj. mblihet nga një rrjet i brendshëm kanalizimesh të cilët mblihen në një kolektor kryesor. Ky kolektor i shkarkon këto ujëra të ndotur në një vaskë dekantuese. Ujërat që kapërderdhen shfrytëzohen për vaditje të tokave bujqësore pronë e investitorit ose derdhen në përroin e fshatit.

Ujërat e zeza shkarkojnë në një gropë septike me vëllim 5 m^3 .

d. Sistem i mbrojtjes nga zjarri.

Investitori e ka vlerësuar rrezikun e rënies së zjarrit, dhe ka vendosur në pika të ndryshme të ambienteve të tij të punës, fikse zjarri me shkumë dhe pluhur. Është e këshillueshme që, këto fikse duhet të kontrollohen nga specialistët përkatës të MNZ, për të vlerësuar gjendjen e tyre teknike.

V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi disa vjeçar i aktivitetit të punishtes së ullirit, ka bërë të mundur identifikimin e disa ndikimeve negative në zonën e zhvillimit të punimeve si dhe në afërsi të saj.

5.1. Shkarkime në ajër.

Shkarkimet në ajër vijnë si pasojë e shkarkimeve të produkteve të djegies së GLN dhe bërsive të ullirit, monoksid karboni (CO), gaz karbonik (CO₂), gaz sulfuror (SO₂), okside të azotit (NO_x) dhe pluhur. Megjithëse kemi shkarkime në ajër duhet theksuar që këto shkarkime nuk janë toksike.

5.2. Shkarkime në tokë.

Zhvillimi i kësaj veprimtarije shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë. Bërsi të ullinjve, në një sasi prej rreth 0.75 – 0.80 ton në sezon. Lëndë të tjera të ngurta që gjenerohen

janë ambalazhe plastike, kartoni, letre si dhe mbetje urbane. 75 % e bërsive përdoren si pleh organik nga fermerët e shoqatës dhe rreth 25 % e sasisë së bërsive përdoret si lëndë djegëse në kaldajë. Mbetjet e tjera/urbane hidhen çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të qendrës së banuar dhe largohen prej aty, për në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane, nga një subjekti përkatës i caktuar.

5.3. Shkarkime të ujrave të ndotur.

Ujërat që shkarkohen nga aktiviteti i kësaj punishteje janë ujërat që dalin gjatë larjes së ullinjve, pastrimit të pajisjeve dhe enëve të nevojshme si dhe ujërat që dalin gjatë pastrimit të ambienteve të punës. Të gjitha ujërat që dalin nga pastrimet e ndryshme kalojnë në një vaskë dekantimi, ku largohen/mbesin grimcat e ngurta. Ujërat që dalin nga vaska e dekantimit dhe ujërat e zeza shkarkojnë së bashku në një rrjet kanalizimesh dhe më tej në Përroin e fshatit.

5.4. Shkarkime të zhurmave.

Gjatë punës të pajisjeve/makinerve që kryejnë procese të ndryshme teknologjike, në afërsi të këtyre makinerve/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat, kryesisht në sallën e makinerve dhe në magazinën e produktit. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Subjekti KRISTINA IDRIZI me NIPT M32923201U, ushtron veprimtarinë e prodhimit të vajit të ullirit në fshatin Mjekës, Shirgjan, Elbasan.

Veprimtaria që vlerësohet në këtë raport, gjendet në Fshatin Mjekës, që ndodhet në administrimin e njësisë së qeverisjes vendore Shirgjan të Bashkisë Elbasan. Njësia Administrative Shirgjan shtrihet në një territor kryesisht fushor-kodrinor, me një shtrirje relativisht të madhe prej 2028 hektarë, duke përfshirë sipërfaqje të konsiderueshme të tokave arë, pyjeve, livadheve dhe kullotave.

Ky fshat gjendet rreth 3 km larg (në rrugë automobilistike) nga Qyteti i Elbasanit drejtë qytetit të Cërrikut. Ai ka një terren pothuajse fushor që fillon nga bregu i lumit deri në kodrat e Gjonmit, me një lartësi rreth 150-200 metra mbi nivelin e detit. Është një fshat me zhvillim tërësisht bujqësor e kondicionuar kjo edhe nga toka të mira bujqësore, të sistemuara me kanale drenazhi dhe ujitje.

Pejsazhi dhe ndërtimi topografik i rajonit ku zhvillohet kjo veprimtari është ai i një zone të banuar rurale, në të cilën mbizotërojnë banesat publike një deri dy katëshe të rrethuara me oborre të gjelbëruara dhe toka të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore.

Objekti në të cilin zhvillohet veprimtaria e këtij subjekti, gjendet në fshatin Mjekës. Është një objekt i rikonstruktuar dhe i përshtatur me veprimtarinë që zhvillohet këtu. Ai është i përfshirë

brenda koordinatave të pasqyruara në tabelën e mëposhtme sipas sistemis Gauss-Kruger WGS84:

Nr. i pikës	X	Y
1	4555378	799404.47
2	4555416.72	799551.31
3	4555407.48	799556.57
4	4555368.33	799407.48

6.1. Përshkrim të faktorëve klimatikë.

Rajoni përfshihet në zonën e klimës mesdhetare, me dimër të shkurtër e të butë dhe me verë të nxehtë e shumë të thatë. Temperatura **mesatare** e ajrit varion nga 7 °C në Janar deri në 24 °C në Korrik.

Erërat që fryjnë nga Veri – Lindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4,7 m/sek. Në pranverë çfaqet drejtimi i dytë dominues i erërave, Jug – Perëndim në 11,9 % të vitit.

Përsa i përket rreshjeve, pjesa më e madhe e tyre bie në periudhën e ftohtë të vitit dhe më pak në periudhën e ngrohtë për shkak të aktivitetit ciklonik. Gjatë periudhës së ftohtë të vitit bie 65 % e shumës vjetore të reshjeve dhe gjatë periudhës së ngrohtë 34 %. Shuma vjetore e reshjeve është 1145 mm, ndërsa maksimumi 24 orë i reshjeve është 135 mm.

6.2. Peisazhi dhe Topografia.

Pejsazhi i zonës në të cilën zhvillohet projekti i propozuar është ai i një zone rurale. Gjatë viteve të fundit vërehet një zhvillim i linjave teknologjike prodhuese mbështetur kryesisht te biznesi familjar.

Teritori i administruar nga Bashkia Elbasan shtrihet në zonën qendrore të vendit tonë. Pjesë e rëndësishme e këtij teritori është edhe fusha e Elbasanit e cila, përfshin zonën nga Labinoti Fushë deri në Papër. Fusha e Elbasanit është pjesë e luginës së Lumit Shkumbin, në rrjedhën e mesme të tij dhe është ndërtuar kryesisht nga formacione molosike. Ajo është një fushë e formuar në periudhën e Kuarternarit dhe nga pikpamja gjeologjike në të takojmë :

- ✓ depozitimet e Oligocenit të Mesëm;
- ✓ depozitimet e Oligocenit të Sipërm;
- ✓ depozitimet e Tortonianit;
- ✓ depozitimet e Kuarternarit

6.3. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Pjesë e rëndësishme e hidrografisë së këtij rajoni është Lumi Shkumbin dhe Baseni i Shkumbinit që përmbledh ujrat nëntokësore.

Lumi Shkumbin shtrihet tërësisht brenda teritorit të vendit tonë. Burimet e tij fillojnë në fshatrat e rretheve Pogradec dhe Librazhd dhe grykëderdhja e tij është në detin Adriatik. Ai përshkon rrethet Librazhd, Elbasan, Peqin, Kavajë dhe Lushnjë.

Pjesa më e madhe e degëve të lumit Shkumbin përfshihen në zonën malore e kodrinore të pellgut ujëmbledhës ndërsa, një pjesë e vogël e tyre shtrihet në ultësirën adriatike. Ky lumë grumbullon ujrat e një teritori me karakter të theksuar malor çka e tregon dhe lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës e cila është prej 753 m mbi nivelin e detit.

Pellgu ujëmbledhës i lumit Shkumbin ka këto karakteristika :

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të Lumit Shkumbin është 2445 km².

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 753.2 m.

Gjatësia 181.4 km.

Gjerësia mesatare 13.4 km.

Prurjet e lumit Shkumbin maten me anë të matësave hidrometrike të cilët janë vendosur përkatësisht në Qukës (Librazhd), Murrash (Papër) etj. Prurjet maksimale të lumit Shkumbin varrojnë nga 250 m³/sekondë në Qukës deri në 1700 m³/sekondë në Rrogozhinë.

6.4. Flora dhe fauna e kësaj zone përbëhet nga ajo e butë që trajtohet nga banorët si dhe ajo e egër.

Tokat arë janë tërësisht të shfrytëzuara e të mbjella me bimë të arave, perime e bimë të cilat përdoren si ushqim për blegtorinë e imët si dhe shpendët. Vitet e fundit në zonat kodrinore ka marrë zhvillim të qëndrueshëm mbjellja dhe rritja e ullirit. Pyjet e Shirgjanit janë me origjinë farore dhe llastore ndërsa sa i përket natyralitetit, të pyjeve duhet pohur se rreth gjysma e tyre janë pyje natyralë. Dominante në këtë zonë janë shkurret mesdhetare të përfaqsuara nga manaferra (*rubus fruticosus*). Bimësia barishtore është dhe deri diku e larmishme me dëndësi nga e rrallë deri në të dendur. Llojet kryesore të bimësisë barishtore që vegjetojnë në këtë zonë janë : grami (*cynodon dactylon*), hithra (*urtica dioica*), gjëmbat, (*cirsium spp*, *silybum spp.*), luledelja (*bellis perennis*) etj. Kjo bimësi është përgjithësisht spontane dhe varion nga e rrallë deri në mesatare. Pjesën më të madhe në pyje e zënë grumbujt pyjore të shkurreve. Cungishtet përfaqësohen nga qarri, bunga e bunga e butë dhe janë kryesisht grumbuj të rinj. Pyjet trungishte janë të lartë dhe zënë rreth 1.5 % të sipërfaqes totale pyjore me llojet si pisha e egër, dushqet dhe akacie

Kjo njësi administrative është e njohur për kultivimin e frutikulturës ku duhen përmendur pemëtarinë, si vreshta, qersh, ullishte dhe kumbulla. Vreshtaria është tendencë e kohëve të fundit dhe gjithnjë e më shumë njej rritje.

Është një zonë që mbarështron kryesisht delen dhe lopën si dhe shpendët shtëpiake ku vendin kryesor e zë gjeli i detit. Në këtë zonë ndeshemi kryesisht me shpend vendas apo emigratorë, zvarranikë, etj. Zogjtë që jetojnë këtu janë trumcakë, mëllenja, etj. Ndër zvarranikët mund të përmendim breshkë toke mesdhetare (*testudo hermani*), gjarpërinj, hardhuca (*Lacerta viridis*), bretkosa të vogla të zakonëshme uji (*rona lessonae*), etj.

Speciet e faunës dhe të florës të takuara në këtë zonë, u kërkuan për t'u gjetur në speciet në rrezik të faunës dhe të florës të detajuara dhe të vlerësuara në "Libri i Kuq i Faunës Shqiptare" dhe "Libri i Kuq i Florës Shqiptare", dy libra këto të publikuar nga Ministria Mjedisit,

respektivisht në vitin 2006 dhe 2007. Nga ky verifikim rezulton se, nuk kemi asnjë prej llojeve /specieve të pranishme në këtë zonë me llojet/speciet e listuar në këto libra.

VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Eksperienca disa vjeçare e veprimtarisë së punishtes së vajit, ka treguar se kemi shkarkime të përkohëshme në ajër, gjenerim të zhurmave si dhe, menaxhimit të mbetjeve të ngurta teknologjike përfshirë këtu edhe të mbetjeve urbane.

7.1. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme, në mjedis.

a. Shkarkime në ajër.

Shkarkimet në ajër vijnë si pasojë e shkarkimeve të produkteve të djegies së GLN dhe bërseven të ullirit, monoksid karboni (CO), gaz karbonik (CO₂), gaz sulfuror (SO₂), okside të azotit (NO_x) dhe pluhur. Megjithatë kemi shkarkime në ajër duhet theksuar që këto shkarkime nuk janë toksike.

b. Gjenerimi i zhurmave.

Gjatë punës të pajisjeve/makinerive që kryejnë procese të ndryshme teknologjike, në afërsi të këtyre makinerive/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat, kryesisht në sallën e makinerive dhe në magazinën e produktit. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

c. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë. Bërsi të ullinjve, në një sasi prej rreth 0.75 – 0.80 ton në sezon. Lëndë të tjera të ngurta që gjenerohen janë ambalazhe plastike, kartoni, letre si dhe mbetje urbane. 75 % e bërseven përdoren si pleh organik nga fermerët e shoqatës dhe rreth 25 % e sasisë së bërseven përdoret si lëndë djegëse në kaldajë. Mbetjet e tjera/urbane hidhen çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të qëndrës së banuar dhe largohen prej aty, për në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane, nga një subjekti përkatës i caktuar.

d. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.

Nuk vlerësohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë zonë, ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjrike, rrugësh etj. janë të përfunduara. Në periudha të përcaktuara, kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjrike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

e. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk dëmtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për "Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundshme" për t'u shpallur "Peizazh i mbrojtur".

f. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të punishtes së vajit nuk shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësor të mjedisit të vendit ku ponohet dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme,
- emetime në ajër të gazeve helmuese
- kontaminim të tokës.

7.2. Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.

a. Vlerësimi i ndikimeve.

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerie egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.
- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe, në treguesit mjedisor të subjektit të dalë gjatë punës disa vjeçare të tij, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimeve të identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohëzgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.

- Përafron ato me objektivitet me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

Në rastin tonë, kemi të bëjmë me ndikime të përkohëshme negative të shkarkimeve në mjedis si psh shkarkim të produkteve të djegies së GLN dhe bërsive të ullirit, monoksid karboni (CO), gaz karbonik (CO₂), gaz sulfuror (SO₂), okside të azotit (NO_x) dhe pluhur.

d. Kthyeshmëria

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparëshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe rigjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

e. Rëndësia.

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimit të identifikuar.

f. Llojet e ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte).

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit të lysterjeve të automobilave, janë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këtë linjë teknologjike, gjejmë se ato duhet të realizojnë qëllimin për të cilën janë vendosur dhe

funksionojnë në këtë proces teknologjik. Vënia plotësisht në punë e tyre për një periudhë relativisht të gjatë kohe, si dhe kryerja e monitorimeve respektive minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analiza e të cilave do të dëshmojë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i zhvillimeve në këtë veprimtari dëshmon se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk kanë influenca mbetëse në cilësinë e mjedisit dhe nuk mund të çojnë më tej në përqendrim të treguesve cilësor aktualë të mjedisit.

IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.

Disa prej përparësive të zgjedhjes së këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- Gjendet në një zonë me infrastrukturë inxhinjere të plotësuar.
- Është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- Gjenden lehtësisht persona të arsimuar dhe kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuar nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluar si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).

Drejtuesit teknik dhe ligjor të subjektit i kanë kushtuar vëmendje maksimale eliminimit të të gjitha llojeve të mbetjeve të krijuara nga kjo veprimtari. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

- a. Mbetje e teknologjike të ngurta, që dalin gjatë proceseve të prerjes, kontrollit teknik etj.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë. Bërsi të ullinjve, në një sasi prej rreth 0.75 – 0.80 ton në sezon. 75 % e bërsive përdoren si pleh organik nga fermerët e shoqatës dhe rreth 25 % e sasisë së bërsive përdoret si lëndë djegëse në kaldajë.

- b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, drurit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerzore etj.

Të vetmet lëndë të ngurta që gjenerohen janë ambalazhe plastike, kartoni, letre si dhe mbetje urbane. Mbetjet urbane hidhen çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të qëndrës sa banuar

dhe largohen prej aty, për në sheshin e depozitimit të mbetjeve urbane, nga një subjekti përkatës i caktuar.

XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europjan, kryesisht në Itali. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit individual të punës së tyre, sepse i tillë është edhe operacioni i punës së tyre. Kështu çdo njëra prej tyre punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të tjera. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjie të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorrëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim efiçent të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim efiçent të energjisë elektrike.

XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që ushtron këtë veprimtari, në shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Kështu duhet të pranojmë që personeli punojës ka fituar eksperiencën e mjaftueshme në realizimin e prodhimeve të përcaktuara si dhe në shfrytëzimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike. Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme plotësimi i këtyre rregulloreve me ato të mbrojtjes nga zjarri si dhe të manovrimeve që duhet të kryhen në rastet e ndodhjes së aksidenteve të ndryshme, teknike e teknologjike.

Krahas tyre duhet të vijojë trajnimi i punonjësve të këtij subjekti për njohjen e plotë të të gjitha rregulloreve të hartuara.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjrike (ndërtesë, rrjete inxhinjrike etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana financiare ashtu edhe në perspektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe, për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarie.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Egziston një përvojë pozitive në ndërprerjet e përkohëshme të aktivitetit prodhues në këtë linjë teknologjike. Këto ndërprerje janë të zakonshme, nisur nga organizimi i punës vetëm me një turn dhe me ditë pushimi javor dhe të të gjithë festive zyrtare.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedura të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit financiar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të përgatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do të hidhen mbeturinat që do të krijohen, metalike, plaste, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarie nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.

Parametri	Frekuenca e monitorimit	Akresi në vendodhjet e matjeve
Niveli i zhurmave	Çdo 6 muaj	Salla e makinerive
		Magazina e produktit

- FUND -

Ermed Baya
20
Baya

